

MULIGAN

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS07



GHS08



GHS09

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

MULIGAN është insekticid, që vepron si rregullator ritjeje për insektet (IGR). Ai vepron me kontakt ose pas gëlltimit dhe qëndrueshmëria e tij mjaft e lartë bën të mundur që në shumë raste të mos ketë nevojë për përsëritje trajtimi. Është tepër aktiv kundër breshkëzave dhe krahë bardhave kur përdoret në fazat e para të zhvillimit të tyre.

Lënda vepruese: 10% w/v Pyriproxyfen;

Formulumi: *Concentrat i emulsionueshem (EC).*

GRUPI	7C	INSEKTICID
-------	-----------	------------

Masat parambrojtëse:

- Mbajeni larg fëmijëve;
- Shmangni thithjen e solucionit;
- Mbajeni larg ushqimeve të njerëzve dhe kafsheve, ujit të pijshëm;
- Gjatë punës mos hani dhe mos pini lëngje dhe duhan;
- Vishni doreza mbrojtëse dhe mbrojtëse të tjera për fytyrën dhe sytë;
- Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorimin;
- Shkatërrimi: Hidhni përmbajtjen/enën në përputhje me rregulloren aktuale për mbeturinat e rrezikshme.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Udhëzime të përgjithshme: Mos nxisni të vjellat: rrezikon hyrjen në mushkri të të vjellave, Asnjëherë mos i jepni lëngje ose të nxisni të vjellat nëse pacienti është i pandërgjegjshëm ose ka përzierie (trazira). Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore ose tregojuni mjekëve këtë ambalazh ose etiketë;
- Në rast kontakti me rrugët e frymëmarrjes: Në rast se thithni avuj, vendoseni personin në mjedis me ajër të freskët. Kërkoni këshillë mjekësore;
- Ekspozimi i përseritur mund të shkaktojë thatësi dhe çarje të lekurës. Në rast kontakti me lëkurën: Lahen me shumë ujë dhe sapun, duke përfshirë flokët dhe zonën poshtë thonjve. Kërkoni këshillë mjekësore nëse ndodh irritim;
- Shkakton dëmtime serioze të syve. Në rast kontakti me sytë: Shpëlajini sytë me kujdes me ujë të bollshëm. Hiqni lentet e kontaktit nëse është e mundur dhe shpëlajini sërish. Konsultohuni me mjekun nëse shfaqen shenja pezmatimi;
- Nëse gëlltitet: Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni etiketën. Konsultohuni me mjekun dhe tregojini ambalazhin ose etiketën;
- Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik. Telefononi menjëherë qendrën e helmimeve dhe mjekut ose specialistit nëse nuk ndiheni mirë.

Përdorimi:

Përdoreni si spërkatje normale gjethore, me sasi uji të mjaftueshme deri sa bimëve t’u mbulohen të gjitha pjesët mbitokësore.

Agrumet (pjeshka dhe nektarina): kundër breshkëzave, spërkasni vetëm kur shfaqen larvat e para. Bëni vetëm një spërkatje për sezon.

Kajsia, qershia, ulliri, farorët, rrushi për verë dhe i tavolinës: bëni vetëm një spërkatje para lulëzimit.

Perimet (domate dhe patëllxhan, vetëm në sera): bëni vetëm një ose dy spërkatje. E para sapo shfaqen insektet e para të rritura të krahëbardhave, dhe e dyta, 2-4 javë më vonë, nëse është e nevojshme.

Tek bimët zbukuruese, në sera: një ose dy spërkatje në sezon. E para duhet bërë sapo të shfaqen disa insekte të rritura dhe, nëse është e nevojshme, spërkatja duhet përsëritur 2-4 javë më vonë. Kundër breshkëzave, bëni spërkatjen sapo të shfaqen larvat e para dhe nëse nevojitet, përsërisni trajtimin 10 ditë më vonë. Në rastin e bimëve zbukuruese në fushë, bëni vetëm një spërkatje në stinë.

Përdorimet	Kundër	Sasia (ml/100 lit)
Agrume (mandarina, portokalli, limoni)	Breshkëzat (Aonidiella, Aspidiotus, Saissetia, Ceroplastes, ndër të tjera)	50-75
Bërthamorët (pjeshkë, nektarinë, kumbull)	Quadraspidiotus perniciosus dhe breshkëza të tjera, Diaspia pentagona	37,5 - 50
Bërthamorë të tjerë (kajsi, qershi)	Quadraspidiotus perniciosus dhe breshkëza të tjera, Diaspia pentagona	37,5-50
Farorët (dardhë, mollë)	Quadraspidiotus perniciosus	37,5-50
Ulli	Saissetia oleae	25-30
Rrush tavoline dhe vere	Planococcus spp dhe Parthenolecanium spp.	50-75

Vërejtje për përdorimin:

Rekomandimet dhe informacioni i dhënë nga kjo etiketë janë rezultat i testeve dhe studimeve të shumta. Megjithatë, disa faktorë që mund të ndikojnë në efektivitetin e produktit, mund të dalin jashtë kontrollit (p.sh përzierjet, sistemi i përdorimit, moti).

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret me dozat dhe në kulturat e rekomanduara.

Ndikimi në mjedis:

Pak helmues për bletët. Shumë helmues për organizmat ujorë, mund të shkaktojë efekte të dëmshme afatgjata në mjediset ujore. Mos ndotni ujin me produktin ose ambalazhin e tij (mos lani pajisjet e aplikimit afër sipërfaqeve ujore/shmangni ndotjen nëpërmjet ujërave të zeza të fermave ose rrugëve). Shmangni hedhjen në mjedis.

Për të mbrojtur organizmat ujorë, lini një zonë të pa trajtuar prej:

Kulturat bujqësore	Pajisje klasike	Pajisje që ul driftin e tretësirës deri 50%
Agrume	25 m	15 m
Dru-frutorë farorë dhe bërthamorë	15 m	10 m
Vreshta, ullinj, bimë zbukuruese	10 m	--

Karenca:

Agrume (mandarina, portokalli, limoni) 30 ditë; Bërthamorët (pjeshkë, nektarinë, kumbull) 15 ditë; Bërthamorë të tjerë (kajsi, qershi) 0 ditë; Farorët (dardhë, mollë) 0 ditë; Ulli 0 ditë; Rrush tavoline dhe vere 0 ditë; Domate, patëllxhan, spec dhe trangull në 3 ditë; Bimë zbukuruese (bimë të ulëta dhe drurë) 0 ditë.

Magazinimi:

Ruhet në vende, të fresketa dhe në ambalazh origjinal.

Numri dhe data e regjistrimit: 785, datë 29.4.2022;

Sasia neto e PMB-së apo lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1 lit;

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese: _____;

Data e prodhimit: _____;

Datën e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje: 3 vjet;

Lloji i ambalazhit bazë: COEX dhe HDPE;

Emri dhe adresa e prodhuesit: Proplan-Plant Protection Company. **Adresa:** Madrid, Spanje;

Emri dhe adresa e kërkuesit: Proplan-Plant Protection Company. **Adresa:** Madrid, Spanje.